



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 186 / Prot.
16

Tiranë, më 22.06.2015

VENDIM

Nr. 40 ,datë 22/06/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Z. _____, përfaqësuar me prokurën nr. 798Rep. dhe Nr.296 Kol., nga Av. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 186/3 Prot., datë 01.06.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Bashkia Durrës, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi më datë 02.05.2015 ka kërkuar nga Bashkia Durrës informacionin dhe dokumentacionin lidhur me pronën “Truall”, me nr. 4/225 Z.K 8514, regjistruar në vol 8 fq.56, me sipërfaqe 1000m, sipas certifikatës lëshuar nga Z.V.R.P.P Durrës.

Ankuesi pretendon se kërkesa e tij nuk është trajtuar sipas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15/1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nga Autoriteti Publik/ Bashkia Durrës. Lidhur me verifikimin ankesës, Komisioneri me shkresën nr.186/5Prot., datë 11.06.2015, kërkoj nga Autoriteti Publik/ Bashkia Durrës, brenda datës 16.06.2015 të dërgonte parashtrimet lidhur me refuzimin e dhënies së informacionit. Kjo e fundit nuk ka informuar Komisionerin edhe pas kalimit të afatit të caktuar për këtë qëllim.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, nga Komisioneri konstaton se informacioni i kërkuar, në kuptim të nenit 7 pika 1 gërma d), të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përbën informacion publik dhe si i tillë i duhet vënë në dispozicion kërkuarit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e /Z. _____, përfaqësuar me prokurë nga Av. _____ kundër Autoritetit Publik/ Bashkia Durrës, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Z. _____, përfaqësuar nga Av. _____, nr. 186/3 Prot., datë 01.06.2015, kundër Autoritetit Publik/ Bashkia Durrës, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Bashkia Durrës, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 22.06.2015.

